



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2022:108403  
Datë: 18.11.2024  
Numri i dokumentit: 06465893

Pml.nr.599/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare Agim Maliqi dhe Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të pandehurit M. B., për shkak të veprës penale vrasja e rëndë nga neni 173 par.1, nënpar.1.3, 1.4 dhe 1.11 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga mbrojtësi i të dënuarit, kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamentit për Krime të Rënda PAKR.nr.94/2024 të datës 22.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 5 nëntor 2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit M. B., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamentit për Krime të Rënda PAKR.nr.94/2024 të datës 22.05.2024, përkitazi me kualifikimin juridik të veprës penale si dhe vendimin për dënim në atë mënyrë që të dënuarin e shpall fajtor për veprën penale vrasja e rëndë nga neni 173 par.1, nënpar.1.3 dhe 1.11 lidhur me nenin 18 par.2 të KPRK-së dhe e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjetë) vite e njëkohësisht i shqipton masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në ndalim në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor- Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në Prishtinë deri sa të jetë i nevojshëm trajtimi i tij. IPFK obligohet që të dërgoj raporte në formë të shkruar në gjykatën e shkallës së parë deri sa i dënuari të trajtohet në këtë institucion. Pjesët e tjera të aktgjyqimit të kundërshtuar mbeten të paprekura.

A r s y e t i m

## **Vendimi i Gjykatës Themelore**

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda me aktgjykimin PKR.nr.262/2022, të datës 03.04.2023, të dënuarin M. B. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale vrasje e rëndë, nga neni 173, par.1, nënpar.1.3, 1.4 e 1.11 të KPRK-së, për të cilën vepër gjykata e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjetë) vite, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë. Të dënuarit, me aktvendim të veçantë i është vazhduar masa e paraburgimit derisa ky aktgjykim të merr formën e prerë, por jo më shumë se dënimi i shqiptuar me aktgjykimin e kësaj gjykate. Koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 27.05.2022 i llogaritet në dënimin e shqiptuar. Në pajtim me nenin 85 të KPRK e lidhur me nenet 513, 514 dhe 515 të KPP, të dënuarit i është shqiptuar edhe masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në ndalim në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor. Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor e shqiptuar ndaj të dënuarit do të zgjasë për aq kohë sa do të ketë nevojë për trajtimin mjekësor-psikiatrik për të dënuarin. Kohëzgjatja e masës së trajtimit të detyruar psikiatrik me ndalim, do të bazohet në raportet dhe rekomandimet e ekspertëve të psikiatrisë pranë Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në Prishtinë. Masa e trajtimit të detyruar psikiatrik ndaj të dënuarit do të ekzekutohet në institucionin e kujdesit shëndetësor në Institutin e Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë. Obligohet Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në Prishtinë, të pranoj të dënuarin M. B. për trajtim mjekësor në kohën siç është paraparë në dispozitivin e këtij aktvendimi. Instituti i Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë obligohet që t'i dërgoj raporte me shkrim kësaj gjykate mbi gjendjen shëndetësore dhe suksesin e trajtimit brenda periudhës 6 mujore. Në bazë të dispozitës së nenit 169 par.4 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve penale së pari do të ekzekutohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor. Koha e kaluar në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim në bazë të nenit 515 par.3 të KPP-së. Gjykata mund të pushoj apo ndryshoj masën e trajtimit të detyruar psikiatrik me ndalim, atëherë kur sheh të nevojshme dhe pasi që të ketë pranuar raportet dhe rekomandimet e ekspertëve të psikiatrisë për ndryshimin apo pushimin e masës bazuar në suksesin e trajtimit mjekësor. Gjykata nga i dënuari në mënyrë të përhershme konfiskon dy thikat të cilat janë përdorur për kryerjen e veprës penale, të cilat pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë do të asgjësohen nga Policia e Kosovës. Është obliguar i dënuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 550 €, paushallin gjyqësor në shumë prej 30 €, në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 50 €.

## **Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës**

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamentit për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.94/2024 e datës 22.05.2024, ka aprovuar si të bazuar ankesat e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarës dhe ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në atë mënyrë që të dënuarin M. B., për veprën penale të shpallur fajtor e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 23 (njëzetetri) vitesh, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 27.05.2022 e tutje dhe duke anuluar vendimin për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit

shëndetësor. Ankesa e mbrojtësit të të dënuarit është refuzuar si e pabazuar, kurse pjesët e tjera të aktgjykimit kanë mbetur të pandryshuara.

### **Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë**

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokati Mahmut Halimi nga M., për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe për shkak të shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, duke i propozuar Gjykatës Supreme të Kosovës, që ta aprovon si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshohen aktgjykimet e kundërshtuara, në atë mënyrë që i dënuari të shpallet fajtor për veprën penale të vrasjes nga neni 173 par.1, nënpar.1.3 dhe 1.11 lidhur me nenin 18 par.2 të KPRK-së, për të cilën do të shqiptohet një dënim më i ulët, të i shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor ose aktgjykimet të anulohen dhe çështja të kthehet gjykatës së shkallë së dytë në rigjykim.

### **Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit**

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.347/2024 e datës 04.10.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

### **Pretendimet e paraqitura në kërkesë**

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë është refuzuar ankesa e mbrojtësit të të dënuarit ndërsa është aprovuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar, me ç'rast është ndryshuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë duke e gjykuar të dënuarin me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 23 (njëzetetre) vite. Pretendohet se me këtë rast gjykata e shkallës së dytë ka shkelur ligjin penal në dëm të të dënuarit duke hedhur në tërësi mendimin e ekspertëve të psikiatrisë të konstatuar përmes ekspertizës së ekspertëve të Institutit të Forenzikës Psikiatrike të Kosovës dhe gjithashtu edhe dëgjimit të ekspertes Dr.V. B.- R. të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, me ç'rast është konstatuar se i dënuari në kohën e kryerjes së veprës penale ishte në kufijtë e gjendjes esencialisht të zvogëluar mendore. Për më tepër, gjykata e shkallës së dytë në arsyetimin e aktgjykimit të saj nuk e përfillë ekspertizën e ekspertëve të IFPK-së, kurse njëkohësisht u falë besimin dëshmitareve të dëshmitareve duke u dhënë qëndrime krejtësisht të kundërta e që kjo paraqet interpretim të gabuar nga ana e gjykatës së shkallës së dytë.

Pretendohet se në rastin konkret gjykata e shkallës së dytë nuk bën dallimin mes gjendjes së pallogaritshme të kryerësit në momentin e kryerjes së verës penale e cila gjendje në tërësi e përjashton përgjegjësinë penale dhe kryerësit i shqiptohet vetëm masa e trajtimit psikiatrik, kurse në rastet kur veprimi i të dënuarit kryhet në gjendje esencialisht të zvogëluar, kryerësi i ndërmerr veprime të kryerjes e gjithashtu edhe i planifikon ato, porse gjendja e shëndetit të tij mendor për të kuptuar veprimet e tij është e ngushtuar si rezultat i gjendjes mendore. Pra kjo është edhe arsyeja se në rastet kur vepra penale kryhet në gjendje esencialisht të zvogëluar nuk rezulton me

lirim nga përgjegjësia penale, përkatësisht të njëjtit i shqiptohet dënimi i caktuar dhe krahas dënimit gjithashtu shqiptohet edhe masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në institucionin e mbyllur apo të hapur varësisht nga rasti dhe rrethanat që vlerësohen nga ana e ekipit përkatës mjekësor.

Më tutje pretendohet se arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë nuk paraqet vlerësimin e gjendjes së fakteve të vërtetuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, por polemizon fund e krye me ekspertizën psikiatrike dhe mendimin e ekspertës e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor duke e vënë mendimin mbi mendimin shkencor institucional. Për më tepër, ekspertiza e ekspertëve e përpiluar në formë të shkruar dhe e paraqitur gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e ekspertës Dr. V. B.-R. ka paraqitur të dhënat përkitazi me gjendjen e shëndetit mendor të të dënuarit e karakterizuar me rënie të disponimit për një periudhë të gjatë kohore në pamundësi për të ndërë kënaqësi, ngadalësim psikomotorik, tërheqje sociale, humbje e energjisë, ndjenjë kronike e lodhjes, mungesë e planeve për të ardhmen, pengesa kognitive, probleme në të folur, ankesa somatike, probleme me traktin e tretjes, kokë dhimbje, higjienë e ulur personale dhe se mund të shfaqen ide pa shpresë dhe ide suicidale dhe paranoike. Kurse gjendja e tillë e konstatuar është e filluar para shumë vitesh, përkundër faktit se ka mungesë të ndonjë historie të mëhershme të trajtimit psikiatrik apo psikologjik të tij dhe duke ardhur në përfundim se aftësia e tij për të kuptuar dhe kontrolluar veprimet e tij ka qenë e zvogëluar në shkallë esenciale. Ekspertët në ekspertizën e tyre kanë theksuar edhe gjendjen e përgjithshme të të dënuarit duke theksuar se fillimisht i njëjti kishte ofruar të dhëna të pakta, kurse gradualisht ka vazhduar me dhënien e informatave të përgjithshme e po ashtu edhe për veprën penale që e ka kryer e që aplikimi i masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin shëndetësor mund të rezultoi me rikthimin e vetëdijes për pasojat e shkaktuara dhe me mundësi të ndërmarrjes së veprimeve kundër vetvetes. Mirëpo përkundër këtyre konstatimeve, gjykata e shkallës së dytë edhe pse në mungesë të njohurive nga fusha e psikiatrisë nuk e përfillë ekspertizën e ekspertëve përkatës, por arsyetimin e saj e mbështetë në të dhënat e siguruar nga personat që e kanë njohur të dënuarin, përkatësisht nga nëna dhe halla e tij si dhe dy dëshmitarët D. D. dhe D. S. dhe të cilët nuk kanë njohuri përkitazi me shëndetin mendor të të dënuarit.

### **Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës**

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa është e bazuar.

Edhe pse mbrojtësi në kërkesë pretendon se aktgjykimi i kundërshtuar përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk evidentohen shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, por se bazuar në provat e administruara në këtë çështje gabimisht është zbatuar ligji penal kur është konstatuar se i dënuari nuk ka vepruar me përgjegjësi esencialisht të zvogëluar dhe si rezultat i këtij konstatimi është ashpërsuar dënimi i shqiptuar dhe njëkohësisht është anuluar pjesa e aktgjykimit përkitazi me masën e trajtimit të

detyrueshëm me ndalim. Pra, provat e administruara janë interpretuar në mënyrë të gabueshme dhe janë nxjerr konkludime të gabuara, dhe atë në dëm të të dënuarit, andaj, kjo rrjedhimisht e bën të mundur ndryshimin e aktgjykimit të instancës së shkallës së parë duke e vendosur këtë çështje në mënyrë meritore. Për më tepër, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se meqë në shqyrtimet gjyqësore të të dy instancave më të ulëta gjyqësore, janë marrë në konsideratë të gjitha provat e mundshme për vendosjen e kësaj çështje penale, andaj nuk pati pengesa që kjo gjykatë duhet t'i jap epilog kësaj çështje penale.

Duke shqyrtuar pretendimet konkrete të paraqitura në kërkesën e mbrojtësit të të pandehurit del se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë në shkelje të ligjit penal, meqë gjykata e shkallës së dytë me rastin e ashpërsimit të dënimit përkatësisht heqjes së masës së trajtimit të detyrueshëm me ndalim në mënyrë të gabuar ka dhënë konkludime përkitazi me raportin mbi ekzaminimin psikiatrik të të dënuarit M. B. të datës 23.06.2022 dhe deklaramentit të ekspertës Dr. V. B. –R. e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë përkitazi me ashpërsimin e dënimit dhe heqjen e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, përkatësisht anashkalimit të ekspertizës mbi ekzaminimin psikiatrik të të dënuarit është juridikisht i paqëndrueshëm, kjo posaçërisht duke pasur parasysh udhëzimet e Gjykatës Supreme të Kosovës sipas aktgjykimit Pml.613/2023 të datës 22.12.2023, me ç'rast gjykatës së shkallës së dytë i janë dhënë udhëzime të qarta dhe të plota lidhur me rigjykimin e kësaj çështje penale, por përkundër kësaj edhe aktgjykimi vijues i gjykatës së shkallës së dytë ka rezultuar me ripërsëritje të gabimeve të evidentuara dhe mos përfillje e këtyre udhëzimeve, posaçërisht përkitazi me raportin e ekspertizës mbi ekzaminimin psikiatrik të të dënuarit.

Nga shkresat e lëndës dhe arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë rezulton se kjo gjykatë e ka anashkaluar në tërësi mendimin e ekspertizës së Institutit të Psikiatrisë Forenzike e cila ekspertizë, ka konstatuar se i dënuari M. B. në momentin e kryerjes së veprës penale, aftësinë mendore për ta kuptuar veprën dhe për të kontrolluar veprimet e tij ka pasur të zvogëluar esencialisht dhe i cili konstatim i gjykatës së shkallës së dytë bie në kundërshtim me ekspertizën e Institutit të Psikiatrisë Forenzike, e me të cilën ekspertizë është dhënë mendim mbi shëndetin mendor të dënuarit M. B. dhe vendimin për anulimin e kësaj mase e arsyeton me qëndrimin e saj përmes analizës së deklaratave të dëshmitarëve të dëgjuar në pjesët që kanë të bëjnë me sjelljet e të dënuarit. Përtej kësaj Gjykata Supreme e Kosovës rikujton se nuk është në kompetencën e saj heqja e diskrecionit në vlerësimin e provave të gjykatave të instancave më të ulëta gjyqësore, megjithatë kjo çmuarje e provave në asnjë rrethanë nuk nënkupton se çmuarja e tyre të bëhet në mënyrë arbitrare dhe e cila kalon njohuritë dhe kapacitetet e gjyqtarëve.

Sipas vlerësimit të Gjykatë Supreme të Kosovës nuk është në kompetencën e gjykatës së shkallës së dytë për të ardhur në konkludim të kundërt me ekspertizën e ekspertëve të Institutit të Psikiatrisë Forenzike e aq më pak që raporti i kësaj ekspertize të zëvendësohet me mendim të gjykatës, meqë vlerësimet e ekspertëve bazohen në të arriturat shkencore dhe të cilët janë profesionist të fushës së caktuar e që ekspertizën e tyre e përpilojnë bazuar në njohuritë dhe praktikat përgjithësisht të pranuar, kurse siç rezulton në shkresat e lëndës në rastin konkret

ekspertët përpilimin e raportit të tyre e mbështesin në njohuritë dhe metodat shkencore e që gjyqtarët këto njohuri nuk i kanë. Për më tepër, arsyetimi dhe vlerësimi i gjykatës së shkallës së dytë se aktgjykimin e mbështetë në dëshmitë e dëshmitarëve të dëgjuar për të ardhur deri te konkludimi se bëhet fjalë për person i cili veprën penale nuk e ka kryer në gjendje esencialisht të zvogëluar dhe duke anashkaluar në tërësi raportin e ekspertëve del të jetë një konkludim tërësisht i gabuar. Kjo për faktin se në asnjë rrethanë dëshmitarët e dëgjuar nuk mund të paraqesin mendimin e tyre përkitazi me gjendjen mendore të të dënuarit, mirëpo ashtu siç është përcaktuar edhe me dispozitën e nenit 120 të KPP-së, dëshmitarët mund të japin informacione për veprën penale, kryerësin e saj dhe rrethanat e rëndësishme për procedurën penale. Kurse në rastin konkret del se dëshmitarët kanë paraqitur mendim edhe përkitazi me gjendjen mendore të të dënuarit e që kjo në asnjë rrethanë nuk është në kuadër të njohurive të tyre. Përkundër faktit që gjykata e shkallës së dytë tenton që dëshmitarët të i vesh edhe me petkun e ekspertëve të psikiatrisë e që kjo në asnjë rrethanë nuk do të duhej të ndodhte në këtë rast, por edhe në rastet tjera të ngjashme.

Gjykata Supreme e Kosovës nuk pajtohet me konkludimet e gjykatës së shkallës së dytë se i dënuari veprën penale e ka kryer në gjendje të aftësisë së plotë mendore, meqë ky konstatim bie në kundërshtim të plotë me ekspertizën e ekspertëve të Institutit të Psikiatrisë Forenzike, dhe për më tepër, rikujton faktin se në rastet kur ekzistojnë dyshime se vepra penale është kryer si pasojë e paaftësisë mendore apo aftësisë së zvogëluar mendore është e nevojshme caktimi i ekspertizës me qëllim të pohimit apo mohimit të këtij dyshimi. Pra si rezultat i këtij dyshimi është kërkuar nga ekspertët e fushës përkatëse një ekspertizë e tillë dhe si rezultat i ekzaminimit ekspertët e Institutit të Psikiatrisë Forenzike kanë vlerësuar se i dënuari ka vepruar në gjendje esencialisht të zvogëluar dhe kanë rekomanduar masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor për të dënuarin. Për këtë arsye, kur në procedurë penale lindë dyshimi se një person në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka qenë i përgjegjshëm, gjykata e fton në ndihmë ekspertin përkatës nga kjo fushë. Prandaj, në rastin konkret veprimi i gjykatës së shkallës së dytë në rigjykim të kësaj çështje është në kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 133 paragrafi 1 i KPP-së në të cilën parashihet se me qëllim të ndriçimit dhe vërtetimit të fakteve relevante në procedurë penale mund të angazhohen persona të cilët në bazë të kualifikimit të tyre profesional ndihmojnë organet që zhvillojnë procedurën penale. Përtej kësaj nga leximi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë del nuk janë përfillur udhëzimet e Gjykatës Supreme të Kosovës sipas aktgjykimit Pml.nr.613/2023 të datës 22.12.2023, me ç'rast janë dhënë udhëzime të qarta se si veprohet në rastet kur konstatimet e ekspertëve janë të paqarta, jo të plota apo kontradiktore e që në këtë rast del se edhe në rigjykim gjykata e shkallës së dytë përveç që merr rolin e ekspertëve të fushës përkatëse gjithashtu aktgjykimin e saj e përdorë si instrument të përshkrimit dhe promovimit të biografisë së tij personale dhe njëkohësisht merr rolin e unifikuesit të praktikës gjyqësore jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë.

Gjykata Supreme e Kosovës si rezultat i rikualifikimit juridik të veprës penale shqyrtoj edhe çështjen e vendimit për dënim dhe suke vlerësuar rrethanat në kuptim të dispozitës së nenit 38 të KPRK-së të cilat përcaktojnë llojin dhe lartësinë e dënimit dhe gjeti se rrethanat e vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe njëkohësisht konstatoi se dënimi i shqiptuar është në

harmoni me intensitetin dhe rrezikshmërinë e veprës penale dhe se përmes këtij dënimi të shqiptuar do të arrihet preventiva speciale dhe gjeneralë. Kurse shqiptimi i masës së trajtimit të detyrueshëm me ndalim i përcaktuar me dispozitën e nenit 513 të KPP-së, përkatësisht gjendja e shëndetit mendor të të dënuarit imponon shqiptimin e kësaj mase me kushtet dhe përkufizimet e përcaktuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë e që Gjykata Supreme e Kosovës nuk e sheh të nevojshme që të ripërsëritë edhe një herë në këtë aktgjykim.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 438 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË**  
Pml.nr.599/2024, më 5 nëntor 2024

B.profesional,  
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,  
Valdete Daka